13	F. Rekuperator nxehtesise me fryrje ajri 1000 m ³ /h ne presion 100 Pa, Eficencese minimumi 70%, kembyes DX me kapacitet termik Ng/Ft 8 kW, Ventilatore me inverter, Kompletuar me gjithë kitin e sistemit VRF DX, filtra G4 F7, Mundesi lidhje me sistemin qendror te kontrollit VRF, si dhe gjithë elemente
14	F. Rekuperator nxehtesise me fryrje ajri 500 m ³ /h ne presion 100 Pa, Eficencese minimumi 70%, kembyes DX me kapacitet termik Ng/Ft 4 kW, Ventilatore me inverter, Kompletuar me gjithë kitin e sistemit VRF DX, filtra G4 F7, Mundesi lidhje me sistemin qendror te kontrollit VRF, si dhe gjithë elementet
15	Ashensor deri ne 300kg ngarkesa me dy ndalesa

2.3.8/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.8, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara.

2.3.8/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit te autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.8. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

2.3.8/c OE te paraqese një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik për pajisjet/materialet:

9	F. Njesi e jashtme e modular pompe nxehtesie Inverter VRF Kapaciteti termik ne F/Ng 50.4/50.4 kW, Performanca EER/COP 3.38/4.12, Fuqia elektrike 15.7 kW, Lidhjet elektrike 380-415V / 3 F ~ 50Hz. Pajisjet e jashtme duhet te jene me vazhdimesi ne ngrohje (continues Heating)."
10	F. Njesi e brendeshme kanalore VRF, me kapacitet termik Ng/Ft 2.8/3.2 kW, Fryrja e ajrit 585/495/408 m ³ /h ne presion 50/100 Pa, Fuqia elektrike 98 Wat, Lidhjet elektrike 220-230V / 1 F, kompletuar me gjithë termostat mural me mundesi lidhje me sistemin e kontrollit qendror te sistemit VRF.
11	F. Njesi e brendeshme VRF Kasete me 4 drejtime,kapaciteti termik Ng/F 5.6/6.3, Fryrja e ajrit 1200/1010/820 m ³ /h, lidhjet elektrike 1/220-240/50 Ph-V/Hz, Fuqia Elektrike 145 Wat. kompletuar me gjithë termostat mural me mundesi lidhje me sistemin e kontrollit qendror te sistemit VRF."
12	F. Njesi e brendeshme VRF Murale,kapaciteti termik Ng/F 2.8/3.2, Fryrja e ajrit 600/530/470 m ³ /h, lidhjet elektrike 1/220-240/50 Ph-V/Hz, Fuqia Elektrike 43 Wat. kompletuar me gjithë termostat mural me mundesi lidhje me sistemin e kontrollit qendror te sistemit VRF."

rezulton se autorizimi i prodhuesit per distributorin i paraqitur nga operatori ekonomik nuk eshte i nenshkruar nga palet duke mos provuar marrëdhënien ligjore ndermjet prodhuesit dhe distributorit. Kjo sjell mospërputhje thelbësore me kriterin e kualifikimit sepse në mungesë të këtij dokumentit nuk provohet se distributori ka të drejtën kontraktuale për të tregtuar produktet e prodhuesit. Vetëm një distributor i autorizuar nga prodhuesi mund të garantojë se pajisjet/materialet që ofrohen janë produkte origjinale dhe në përputhje me specifikimet teknike të prodhuesit.

Autoriteti kontraktor duhet të ketë garanci se operatori ekonomik ka të drejtën legjitime për furnizim, bazuar në një zinxhir të qartë furnizimi (prodhues → distributor i autorizuar → operator ekonomik).

- Operatori ekonomik nuk ka ofertuar në përputhje me Seksioni I: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, “Hartimi i ofertës” pika 4. përcaktohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.

Në preventivin pa çmime pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I GODINES BLOKU I , IEVP FUSHE KRUJE

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
a. ANALIZA					
1	PUNIME NDERTIMI	Lekë	1		
2	PUNIME MEKANIKE	Lekë	1		
3	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA a:				
b. PAJISJE JASHTË LISTE					
4	PAJISJE NDERTIMI (ASHENSORI)	Lekë	1		
5	PAJISJE MEKANIKE	Lekë	1		
6	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA b:				
Shuma Analiza (Shuma a)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma b)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

PREVENTIV PUNIMESH NDERTIMORE

Në rastin konkret, nga verifikimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij nuk është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit pasi nga ana e operatorit ekonomik zëri “Shuma TVSH (per pajisjet) nuk eshte plotesuar.

Oferta ekonomike e detajuar

OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I GODINES
BLOKU I , IEVP FUSHE KRUJE

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
a. ANALIZA					
1	PUNIME NDERTIMI	Lekë	1	60634313	60 634 313
2	PUNIME MEKANIKE	Lekë	1	6839050	6 839 050
3	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1	19228620	19 228 620
	SHUMA a:				86 701 983
b. PAJISJE JASHTË LISTE					
4	PAJISJE NDERTIMI (ASHENSORI)	Lekë	1	1485000	1 485 000
5	PAJISJE MEKANIKE	Lekë	1	10420700	10 420 700
6	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1	3049400	3 049 400
	SHUMA b:				14 955 100
Shuma Analiza (Shuma a)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma b)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

PREVENTIV PUNIMESH NDERTIMORE

Referuar dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 6. përcaktohet se:

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të apo çmimet e tyre.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

Në këto kushte, KVO gjykon, se mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim dhe refuzimin e ofertës të operatorit ekonomik “INA” shpk.

Gjithashtu bazuar në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3/c të VKM -së, Nr. 285 e ndryshuar e cila përcakton: ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, për sa më lartë oferta e operatorit ekonomik “INA” shpk refuzohet.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

4. B.O.E “Kevin Konstruksion” shpk “CARA” shpk, pasi me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- Anëtar i BOE “CARA” shpk, me dokumentacionin e paraqitur në SPE nuk plotëson pikën d dhe e të kriterin 2.3.10 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT në të cilën është kërkuar:

- d- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- e- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 27001:2022 e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të sigurisë së informacionit). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i

vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqese ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë përsiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "CARA" shpk nuk ka paraqitur Certifikatë SSH EN ISO 27001:2022 ndersa ka paraqitur në SPE Certifikatën SSH EN ISO 50001-2018, me nr. SME20240328ALCS, të lëshuara nga subjekti "e - C...." sh.p.k.

Nga verifikimi në faqen e web-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, rezultoi se subjekti "e - C...." sh.p.k, me certifikatë akreditimi nr. CS 014, nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues ku DPA bën pjesë, EA (European Accreditation) e cila funksionon sipas Rregullores së Komisionit Europian nr. 765/2008 dhe në të cilën bëjnë pjesë të gjitha organizmat ndërkombëtarë të certifikimit të njohura nga Republika e Shqipërisë, për të lëshuar certifikatën e mesipërme.

Referuar Akt-marreveshjes për bashkimin e operatoreve ekonomik, ndarja e detyrave/zërave të punimeve do të jetë në raportin 40 % "CARA" SH.P.K dhe 60% shoqëria "Kevin Konstruktion" SH.P.K.

Nga verifikimi i preventivit dhe zërave të punimeve që ka marrë përsiper të realizojë "CARA" shpk, është konstatuar se këto punime kërkojnë detyrime të posedimit të certifikatave ISO të kërkuara në kriterin 2.3.10.

Kontretisht punimet që janë të lidhura me Certifikatë SSH EN ISO 50001:2018 dhe janë marrë përsipër të kryen nga operatori ekonomik "CARA" shpk janë zërat e punimeve: "Sistemet VRF (ngrohje-ftohje), Njësiti i jashtë dhe të brendshme VRF, Rekuperatorët e ajrit, Pompa të nxehtësisë, Pompa riqarkullimi, Sistemet e ventilimit dhe BMS, Pajisje apo sisteme me konsum të konsiderueshëm energjie..etj. Ndersa punimet që janë të lidhura me Certifikatë SSH EN ISO 27001:2022 janë punimet: Infrastrukturë rrjeti IT (kabllo UTP, rack cabinets, patch panelë, aksesore rrjeti), Pajisje aktive rrjeti (switch-e, konverterë FO), Sistemi CCTV (kamera, NVR, ruajtje e të dhënave), Serverë dhe pajisje të monitorimit, UPS për pajisjet IT dhe CCTV, Sistemet BMS dhe komponentët e tyre të komunikimit, Panelet e adresuara të zjarrit dhe pajisjet GSM..etj.

- BOE, me dokumentacionin ligjor të paraqitur në SPE nuk plotëson kriterin 2.3.8, kriterin 2.3.8/a dhe kriterin 2.3.8/b të "Kapacitetit teknik" të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, në të cilin kërkohet si më poshtë:

"2.3.8 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

2.3.8/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.8, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materialet. Në rast paraqitje autorizim distributori i autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.8/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.8. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materialet.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

2.3.8/c OE te paraqese një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Ofertuesi për pajisjen e kërkuar në kriterin 2.3.8 me nr. 13 ka ofertuar Modelin DX 50H të prodhuar nga kompania “Viessmann” ndersa për pajisjen nr. 14, Modelin DX 130H të prodhuar po nga kompania “Viessmann”. Nga verifikimi i specifikimeve teknike për këto pajisje:

- “Rekuperator nxehtesise me fryrje ajri 500 m³/h ne presion 100 Pa, Eficencese minimumi 70%, kembyes DX me kapacitet termik Ng/Ft 4 kW, Ventilatore me inverter, Kompletuar me gjithë kitin e sistemit VRF DX, filtra G4 F7, Mundesi lidhje me sistemin qendror te kontrollit VRF, si dhe gjithë elementet” dhe

- “F. Rekuperator nxehtesise me fryrje ajri 1000 m³/h ne presion 100 Pa, Eficencese minimumi 70%, kembyes DX me kapacitet termik Ng/Ft 8 kW, Ventilatore me inverter, Kompletuar me gjithë kitin e sistemit VRF DX, filtra G4 F7, Mundesi lidhje me sistemin qendror te kontrollit VRF, si dhe gjithë elemente” në faqen e internetit <https://www.viessmann.co.uk/en/products/brochures.html> rezulton se specifikimet e pajiseve nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST. Kontretisht nuk përputhet fuqia e pajisjeve të kërkuar në DST.

Vitoclima MICRO DX Recuperatori di calore entalpici

Modello		DX 50H	DX 80H	DX 130H
Portata aria nominale	m ³ /h	500	800	1300
Pressione statica utile nominale	Pa	90	120	110
Alimentazione elettrica	V/ph/Hz	230/1/50	230/1/50	230/1/50
Corrente assorbita max. totale	A	0,6	1,4	2,7
Tipologia motore		EC	EC	EC
Nr. velocità		10	10	10
Controllo velocità		Man	Man	Man
Potenza specifica interna di ventilazione- SFP int ¹⁾	W/(m ³ /s)	547	865	873
Potenza assorbita nominale totale	kW	0,15	0,32	0,50
Livello di pressione sonora	dB(A)	39	42	44
Efficienza termica invernale ²⁾	%	76	76	74,2
Efficienza entalpica invernale ²⁾	%	67	65	59
Efficienza termica estiva ³⁾	%	76	76	74
Efficienza entalpica estiva ³⁾	%	63	63	58
Efficienza termica a secco ¹⁾	%	76	76	74
Potenza termica ⁴⁾	kW	2,5 (2,7)	4,4 (4,8)	6,2 (6,7)
Potenza frigorifera totale ⁵⁾	kW	3,0	5,1	7,0
Dimensioni (LxHxP)	mm	1495X270X955	1685X390X1200	1700X390X1290
Peso	kg	90	100	105
AHU kit		AHU-N36U/A-T	AHU-N71U/A-T	AHU-N71U/A-T

Note:

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

B.O.E “2Z KONSTRUKSION” shpk & “TOTILA” sh.p.k, pasi me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- BOE, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.6 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT në të cilën është kërkuar: Operatori

ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listat pagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Punonjes I izolimeve (Hidroizolues) 3 punonjës

2.3.6/1 Për punonjësit automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listat pagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon stafin teknik sikundër përcaktuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon: 3 (tre) punonjës me profesion “Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)”. Konkretisht, ofertuesi ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës (B.B & XH. T) me profilin e kërkuar në DST.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Operator të kualifikuar 1 (një) operator ekonomik:

- B.O.E “C O L O M B O” shpk, me nr. nipti J82916489E & “AGI KONS” shpk me nr. nipti K21622001M, me subjekte mbështetës “Electrova” me nr. nipti M31423002A & “Eurosteel” shpk me nr. nipti M31423002A & “Al Comm Solutions” me nr. nipti M01427004J, me ofertë ekonomike: 88,166,818.25 tetëdhjetë e tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind e tetëmbëdhjetë pike njëzetë e pesë) lekë pa tvsh;

Pas këtij vlerësimi, në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO bëri kontrollin aritmetik të ofertave ekonomike të vlefshme nga ku rezultoi se nuk ka oferta me gabime aritmetike.

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;

Nr. ofertave = 1

O “C O L O M B O” shpk & “AGI KONS” shpk = 88,166,818.25 lekë

FL= 125,042,240.96 lekë

PR = 25% e FL = 31,260,560.24 lekë

PR = 125,042,240.96 - 31,260,560.24 = 93,781,680.72lekë

O “C O L O M B O” shpk & “AGI KONS” shpk 88,166,818.25 lekë < 35,988,298.80 lekë

Nga llogaritja sipas formulae se mesiperme rezulton se oferta e BOE “C O L O M B O” shpk & “AGI KONS” shpk është anomalisht e ulët. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Sa më sipër, oferta skualifikohet si ofertë anomalisht e ulët.

Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 31, 39, 82 të tij si dhe në zbatim të nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, “Anulimi i një procedure prokurimi” pika 1/b, kur ne procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos të anulojë procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës I të IEVP Fushë Krujë”

Ky procesverbal u hartua në 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë dhe në 2 (dy) kopje të barazvlefshme, nga të cilat 1 (një) e mban KVO dhe 1 (një) administrohet në dosjen me shkrim të procedurës së prokurimit. Proces Verballi u nënshkrua rregullisht nga anëtarët e KVO-së.

Me publikimin e këtij formulari, nisin afatet e ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.